

Data 05.12.2022

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje kancelari dhe zarfa”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**30191000-4 Pajisje zyre përveç mobiljeve, 30199230-1 Zarfa**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**40,577,848 (dyzet milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e tetë) pa TVSH.**

**Në Euro : 348,188.16 (treqind e dyzet e tetë milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë pikë gjashtëmbëdhjetë) Euro, pa TVSH.**

**Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 05.12.2022 është 116.54 Lekë/Euro**

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Posta Shqiptare” SH.A. ka vendosur që kjo procedure të mos jete ne lote sipas arsytimit të mëposhtem:**

Kjo kontrate nuk është ndare në lote pasi administrimi i saj, pra i gjithë bazës materiale objekt kontrate do të administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Posta Shqiptare SH.A, si dhe ndjekja dhe zbatimi i kontratës do të bëhet nga magazina e Drejtorisë së Përgjithshme, ndarja dhe frangmentimi i saj do të krijonte kompleksitet dhe vështirësi në zbatim si dhe do të bente të pazbatueshme kontratën.

Objekti i kontratës lidhet me furnizimin e Kancelari dhe Zarfa për 13 (trembëdhjetë) Filialet e Postes Shqiptare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të cilat do të shpërndahen sipas kërkesave të drejtorive/sektoreve/zyrave përkatëse, si dhe çdo Filiali ,  
Persa me lart ndarja në lote do të nderlikonte dhe vështirësonte procesin e zbatimit të kontratës duke krijuar vonesa dhe rrjedhimisht do sillte vështirësi për stafin kërkues të bazës materiale. Kjo

kontrate nuk mund te ndahet ne lote pasi ne thelb te gjithe artikujt objekt i kontrates i perkasin te njejtës kategori produktësh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Posta Shqiptare sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 99 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar). Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave të kërkuar në këtë procedurë prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të këto realizuar me kontrata të ngjashme, të jete afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK krijon siguri dhe besueshmëri që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.*

---

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001- 2015 ose ekuivalente me të (Certifikata duhet të jete e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Gjithashtu, kjo certifikat është e nevojshme për të vërtetuar që operatori ekonomik ofertues ushtron aktivitet në pajtueshmëri me standardet e kërkuara të cilësisë në raport me objektin e kontratës që do të realizohet sipas standardeve ndërkombëtare ISO.*

2.3.3 Per zarf kartoni per sherbimin EMS me përmasa 230 x330mm operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marreveshje bashkëpunimi ose leter angazhimi me firmen prodhuese per mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet . Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë kapacitete te stafit te tij per te prodhuar gjithë sasine e kërkuar ne kete prokurim si dhe list pagesat sipas formatit E-Sig, ku numri i punonjësve të siguruar të jetë jo më i vogël se 5 (pese) punonjës për **muajin e fundit të maturuar nisur** nga data e hapjes se ofertave. Për plotësimin e kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një vërtetim për numrin e punonjësve të lëshuar nga Administrata Tatimore që vërteton se subjekti ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për **muajin e fundit të maturuar**, shoqëruar me listëpagesën e dorëzuar pranë organeve tatimore për **muajin e fundit të maturuar**.

**Për përmbushjen e këtij kriteri në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST.**

**Sqarim :** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur duke marr ne konsiderate sasine e mallrave te kerkuara objekt i kesaj kontrate, duke pasur parasysh edhe afatin e levrimit dhe te shperdarjes se materialeve sipas specifikime teknike.*

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt 6, 10, 13, 17, 18, 36,37,38,42 të kërkuar sipas listës së artikujve ne Shtojcen 5, Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Dorëzimi i mostrave është shumë i rëndësishëm për procesin e vlerësimit teknik dhe verifikimit të përmbushjes së specifikimeve teknike.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **VLERA LIMIT E KONTRATËS,**

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285,

datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

*1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:*

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

*Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.*

***Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.***

**Njësia e Prokurimit:**